



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.108/3 prot.

Tiranë më 12.5.2023

REKOMANDIM

Nr. 28, datë 12.5.2023

PËR KONTROLLUESIN “CENTURY 21 EVEREST – LEONARD NUHU P.F.”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Century 21 Everest – Leonard Nuhu p.f.” (në vijim, “Kontrolluesi),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 220, datë 12.12.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, me fokus të veçantë masat tekniko – organizative për përpunimin e të dhënave personale të tyre, veçanërisht sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI).*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është agjenci imobiliare dhe ushtron veprimtarinë duke ofruar shërbime ndërmjetësimi, ndër të tjera, aktivitete në fushën e pasurive të patundshme, vlerësimin e pasurive të patundshme, shitje pasurie, administrim pronash etj. Kontrolluesi ushtron veprimtarinë prej vitit 2016, si “Franchise” për shoqërinë “Century21 Albania Shpk”, me emër tregtar “Century 21 Everest”.

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë, “klientë”, “punonjës”, “kandidatë për punë”, etj., në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Gjatë hetimit administrativ u konstatua se “Century 21 Everest” vepron në përputhje me marrëveshjen Franchise lidhur me “Century 21 Albania SHPK”, për pasuri të paluajtshme.

Kontrolluesi, ushtron veprimtarinë nëpërmjet Agjentëve të kontraktuar, të cilët janë subjekte tregtare dhe kanë formë ligjore “Person fizik” dhe punëmarrës. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, nëpunësit dhe agjentët e “Century 21 Everest” aksesojnë sisteme elektronike që janë CRM (*customer relationship management - menaxhimi i marrëdhënieve me klientët*) dhe CMS (*customer management system*), nëpërmjet faqes web, me qëllim regjistrimin e agjentëve, klientëve dhe pronave të tyre, etj. Të dyja sistemet ndërveprojnë së bashku dhe mund të konsiderohen si një paketë shërbimi.

Të dhëna në lidhje me pronat, agjentët dhe zyrat, sinkronizohen/shkojnë nga CRM në CMS të faqes së webit të “Century 21 Everest”.

Sistemi CRM ofrohet online si nëndomain i domain-it kryesor www.bspvision.com. Ky sistem përbëhet nga module të ndryshme, të tilla si: “leads”, “contacts”, “properties”, “profile”, etj., të cilat popullohen, ndër të tjera, me të dhëna personale. Nga verifikimi, u konstatua se sistemi popullohet nga agjentët e Kontrolluesit. Konkretisht, moduli “Leads” popullohet nga subjektet që kërkojnë shërbim nga shoqëria, dhe ndër të tjera, përmban të dhëna personale në lidhje me “emrin klient/broker”, “mbiemrin klient/broker”, “adresën e email”, “numër telefoni”, “shteti”, etj.

Moduli “Contact”, si pjesë e integruar e sistemit CRM, përmban, ndër të tjera, të dhëna personale të pronarëve të pronave që duan të shesin/blejnë apo marrin/japin me qira, dhe lidhen me “emrin klient/broker”, “mbiemrin klient/broker”, “adresë email”, “numër telefoni”, “shteti”, etj.

Njësitë kryesore që përbëjnë sistemin janë “zyra”, “agjenti”, “prona” si dhe “moduli i kontaktit” i pasqyruar si formë kontakti në faqet e internetit të secilit klient. Moduli i formës së kontaktit konstatohet se regjistron të dhëna si: “emër”, “mbiemër”, “adresë emali”, “numër telefoni”, etj.

3. Në faqen www.century21albania.com/en/office/century%2021%20everest.html e cila administrohet nga Kontrolluesi ndër të tjera, gjenden të publikuara të dhënat e agjenteve si “emër”, “mbiemër”, “fotografia e agjentit”, etj. Kontrolluesi nuk ka mundur të dokumentojë pëlqimin e subjekteve të të dhënave “agjentë” për publikimin e të dhënave të tyre në faqen e internetit të sipërcituar, në kundërshtim me kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave të parashikuara në nenin 6 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi, ka detyrimin të marrë masa në lidhje me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale, në respektim të kritereve ligjore të përpunimit, ku parashikohet se përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kriteret e nenit 6 të Ligjit.

4. Nga verifikimi i kontratave të ndërmjetësimit që aplikohen me klientët, të tilla si:

- a. “Marrëveshje ndërmjetësimi – shitje ekskluzive”,
- b. “Marrëveshje ndërmjetësimi – shitje jo-ekskluzive”,
- c. “Marrëveshje ndërmjetësimi – blerje ekskluzive”,
- d. “Marrëveshje ndërmjetësimi – blerje jo-ekskluzive”,
- e. “Marrëveshje ndërmjetësimi – qiradhënie e hapur”,
- f. “Marrëveshje ndërmjetësimi – qiradhënie ekskluzive”,
- g. “Marrëveshje ndërmjetësimi – qiramarrje e hapur”,
- h. “Marrëveshje ndërmjetësimi – qiramarrje ekskluzive”,

Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave (klientë), mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, palët e treta drejt të cilave mund të përhapen, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje), në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale, të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mos përmbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

5. Nisur nga përmbajtja e marrëveshjes së përbashkët “Franchise” në tërësi, rregullores së zyrës Master “Century 21 Albania”, konstatimeve në vend, rezulton se “Leonard Nuhu” person fizik – “Century 21 Everest” e ushtron veprimtarinë e tij, sipas modelit të “Marrëveshjes franchise për pasuri të paluajtshme” që aplikon “Century21 Albania SHPK” (franshizdhënësi), me çdo agjenci (franshizmarrës).

Në bazë të pikës 5, të nenit 3 të Ligjit, “Kontrollues” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Në bazë të pikës 7, të nenit 3 të Ligjit “Përpunues” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që përpunon të dhëna personale në emër të kontrolluesit .

Roli që kanë palët është thelbësor për të bërë rregullimet e duhura, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale. Një Kontrollues është një organ që vendos/përcakton elementët kyç të përpunimit. Kontrolluesi mund të jetë i përcaktuar me ligj ose mund të përcaktohet nga analiza e elementeve apo rrethanave faktike të çështjes. Kushtet e kontratës së aplikuar ndihmojnë në identifikimin e kontrolluesit, megjithëse ato nuk janë vendimtare në të gjitha rrethanat. Referuar përkufizimit të pikës 5 të nenit 3 të Ligjit, “*kontrolluesi*” përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale.

Franshiz marrësi kualifikohet si përpunues i të dhënave, në rastet kur është në cilësinë e marrësit të ekskluzivitetit (*përmes kontratës frachize*) dhe përpunon të dhëna personale, në emër të franshizdhënësit. Ndërsa në rastet kur ai kontraktin palë të treta, me qëllim ofrimin e shërbimeve, (*në të cilat përfshihet edhe përpunim i të dhënave të tij*), Franshiz marrësi merr atributet e Kontrolluesit.

Referuar analizës së mësipërme, si dhe bazuar në analizën e modelit të “*Marrëveshjes franchise për pasuri të paluajtshme*” që aplikon “*Century 21 Albania SHPK*” (franshizdhënësi), me “*Century 21 Everest*” (franshiz marrës), si dhe kompetencave të përfshira në përmbajtje të kësaj marrëveshje sikurse është parashikuar konkretisht në pikat: 4.0 “*Dhënia e licensës*”, 6.0 “*Shërbime dhe detyrime për Franchise*”, 7.0 “*Taksat e Franchise*”, 8.0 “*Fondi marketingut të markës*”, 9.0 “*Teknologjia*”, 10.0 “*Menaxhimi i vullnetit të lirë*”, 11.0 “*Shpenzime dhe detyrime të tjera të Franchise*”, 13.00 “*Mbajtja e të dhënave, Auditimi*”, 14.0 “*Modifikimi i sistemit, përmirësimet*”, etj., pasqyrohet qartë roli i “*Century 21 Albania SHPK*” në cilësinë e Kontrolluesit dhe “*Century 21 Everest*” në cilësinë e përpunuesit.

Gjithashtu, konstatohet se “*Leonard Nuhu*” person fizik, disponon kontratë me shoqërinë “*Best Software Production SHPK*” me objekt: Përdorimin e platformës software online CRM, “*Licensa dhe marrëveshje e shërbimi për software dhe website e BSP Vision SHPK - Real Estate*”. Rezulton se ky akt nuk plotëson kërkesat formale, pasi nuk është i nënshkruar nga të dyja palët, megjithatë, nga provat e administruara gjatë inspektimit pranë “*BSP Vision SHPK*”, në zbatim të Urdhrit nr. 182, datë 17.10.2022 të Komisionerit, është konstatuar ekzistenca e këtij raporti midis palëve.

Në analizë të kontratës dhe marrëdhënies që “*Leonard Nuhu*” person fizik, ka me “*BSP Vision SHPK*”, rezulton se, objekti i kontratës është ofrimi i disa shërbimeve të tilla si: *serverat dhe mirëmbajtja e tyre; krijimi i një template në të cilën do të shfaqen pronat; krijimi i panelit të administratorit, që do të jetë i aksesueshëm përmes www.century21albania.com/admin; ofrimi i backup-it javor të bazës së të dhënave dhe rikthimi i saj në rast se kërkohet nga klienti; ndryshim përdoruesi apo password për të hyrë në platformën e “BSP Vision SHPK” me kërkesë me email të klientit, etj.*

“*Leonard Nuhu*” person fizik, disponon gjithashtu marrëveshje ose kontrata të tjera, të tilla si “*Marrëveshje Bashkëpunimi*” me “*Andi Merkaj*” person fizik, me NIPT M02123003U, ... me zotësi të plotë juridike për të vepruar si Agjent. Objekti i

kontratës është: *“Bashkëpunimi ndërmjet palëve për shitjen e pasurive të paluajtshme apo çdo aktivitet tjetër ndërmjetësimi lidhur me të ..., pasuritë e paluajtshme për të realizuar transaksionet që do të vihen në dispozicion në çfarëdolloj forme, përfshirë listimin elektronik nga agjenti për kompaninë. Ky i fundit i liston ato nën markën “Century 21” për përdorimin e të cilës kompania ka marrë të gjitha të drejtat dhe autorizimet e përdorimit për këtë lloj aktiviteti nga franshizdhënësi i autorizuar i markës Century 21 në Shqipëri, etj.”*

Nga analiza e përmbajtjes së akteve të sipërcituara (Modeli i *“Marrëveshjes franchise për pasuri të paluajtshme”* që aplikon *“Century 21 Albania SHPK”* (franshizdhënësi), me *“Century 21 Everest”* (franshizmarrës), kontrata me *“BSP Vision SHPK”* dhe marrëveshje bashkëpunimi me *“Andi Merkaj”* person fizik, rezulton se në përmbajtje të tyre nuk janë reflektuar detyrimet për përcaktimin e rregullave në lidhje me marrëdhënien mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, me qëllim ofrimin e garancive të plota për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale nga pala kontraktore, sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”*, i ndryshuar (në vijim, *Udhëzimi nr. 19*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, të gjitha detyrimet e sanksionuara në nenin 20 të Ligjit duhet të përfshihen në marrëveshjet/kontratat dhe/ose aneks kontratat e nënshkuara mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit. Çdo kontratë përpunimi (*outsourcing/shërbimi*) që ka për qëllim delegimin e përpunimit të të dhënave personale, duhet të përmbajë dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Çdo kontratë e tillë duhet të parashikojë masat që duhet të marrë Përpunuesi, për të siguruar/garantuar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave, me qëllim që të sigurojë paprekshmërinë e tyre në çdo hallkë të këtij përpunimi.

6. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezulton se Kontrolluesi nuk e ka përmbushur detyrimin për *“Njoftim”*, mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në kundërshtim me parashikimet e nenit 21 të Ligjit. Megjithatë, Kontrolluesi e ka përmbushur Detyrimin për Njoftim, gjatë periudhës së inspektimit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, realizimi i detyrimit për njoftim mbi përpunimin e të dhënave personale dhe për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së Njoftimit të përpunimit të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe në realizimin e

detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

7. Kontrolluesi disponon rregullore *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, por konstatohet se rregullorja nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative, etj., në përputhje me proceset përpunuese, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një *“Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

8. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. Trajnimet duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura, sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit. Zyra e Komisionerit vlerëson se trajnimet duhet të kryhen me qëllim ndërgjegjësimin e operatorëve, të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Kontrolluesi është paraqitur në seancën dëgjimore më datë 19.01.2023, të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe ka deklaruar angazhimin dhe dokumentim për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar, si dhe kanë paraqitur argumentet si vijon:

- Lidhur me konstatimet e pikës 3, Kontrolluesi argumenton se: *“Është nënshkruar kontratë bashkëpunimi ose kontratë punësimi (sipas rastit), dhe pjesë e kësaj kontrate është edhe “Deklaratë Konfidencialiteti”, ku është marrë pëlqimi i agjentit për publikimin e të dhënave. Në këtë kuadër, vlerësojmë se plotësohen dy nga kriteret ligjore të përpunimit të parashikuara në germat “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 6 të ligjit. Për më tepër, agjentët janë në dijeni të plotë të publikimeve pasi edhe të dhënat janë siguruar prej tyre, në kuadër të mbarëvajtjes së punës, dhe qëllimit të kompanisë dhe agjentëve për të siguruar klientë dhe për tu kontaktuar dhe mbajtur marrëdhënie të vazhdueshme, transparente dhe të besueshme me klientët.”*

Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimet e Kontrolluesit nuk qëndrojnë, pasi nisur nga argumenti si dhe analizimi i përmbajtjes së *“Deklaratës së Konfidencialitetit”* të paraqitur në seancë dëgjimore, rezulton se Kontrolluesi nuk e ka të qartë konceptin e pëlqimit, ruajtjes së konfidencialitetit dhe se kujt i adresohet ky i fundit. Në dokumentin e paraqitur gjatë seancës dëgjimore konstatohet se, Kontrolluesi e aplikon *“Deklaratën e Konfidencialitetit”* për *“Klientët”*, ndërkohë që deklarata e konfidencialitetit konsiderohet masë sigurie, e cila detyron kontrolluesin dhe të gjithë ata që përpunojnë të dhëna personale për llogari të tij, të mos përhapin të dhënat personale të siguruar për shkak të ushtrimit të funksionit, edhe pasi të ketë përfunduar marrëdhënia e punës me kontrolluesin. Në këtë kuptim, paraqitet kontradiktor formulimi i kontrolluesit, i cili kërkon nga klientët që të ruajnë të dhënat e tyre personale.

- Lidhur me konstatimet e pikës 6, në lidhje me kontratën me *“BSP Vision SHPK”*, kontrolluesi argumenton se: *“Në lidhje me marrëveshjet e tjera (agjentët), kanë nënshkruar Deklarata Konfidencialiteti, të cilat shoqërojnë marrëveshjet e bashkëpunimit, dhe përmbajnë gjithashtu një aneks, në lidhje me mospërhapjen e informacionit konfidencial, duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimet e nenit 20 të ligjit”.*

Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet e Kontrolluesit mbi përmbushjen e detyrimeve të nenit 20 nuk qëndrojnë, pasi hartimi i *“Deklaratës së Konfidencialitetit”*, nuk ka të bëjë me përmbushjen e detyrimeve në kuadër të parashikimeve në nenit 20 të ligjit dhe Udhëzimit nr.19.

- Lidhur me konstatimet e pikës 8, në lidhje me *“Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, kontrolluesi pretendon se është reflektuar duke bërë ndryshime në rregullore, me rubrikë të veçantë sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet e Kontrolluesit mbi përmbushjen e detyrimeve të nenit 27 nuk qëndrojnë, pasi në seancë dëgjimore, rezulton se nuk është dokumentuar një gjë e tillë.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 6, 18, 20, 21, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/l”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me kriteret ligjore të sanksionuara në nenin 6 të Ligjit, duke garantuar pëlqimin e subjekteve të të dhënave “Agjentë” për publikimin e të dhënave të tyre në faqen e internetit;
2. Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
4. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të përfshijë në “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.
6. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale.
7. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) brenda 5 (pesë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 1 më sipër;
 - (ii) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikat 2 dhe 4 më sipër;
 - (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 3 më sipër;
 - (iv) brenda 45 (dyzet e pesë) ditë, detyrimet e treguara në pikën 5 dhe 6 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijëni të këtij akti;

8. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
9. Në rast mospërbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 12.5.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi